



Република Македонија  
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ

Republika e Maqedonisë  
AVOKATI I POPULLIT

**O M B U D S M A N**  
Republic of Macedonia

Avokati i Popullit-Mekanizmi parandalues nacional (AP-MPN), në suaza të mandatit dhe kompetencave të tij për mbrojtjen e personave të privuar nga liria, me qëllim të parandalimit të torturës dhe llojit tjetër të trajtimit brutal, çnjerëzor, degradues dhe ndëshkues, më datë **23.06.2016**, realizoi vizitë të rregullt dhe të paparalajmëruar në IP Entin special-Demir Kapi.

Qëllimi i kësaj vizite ishte për të kontrolluar dhe monitoruar kushtet materiale, trajtimin dhe veprimet ndaj personave-shfrytëzues të vendosur në IP Enti special-Demir Kapi, të konstatohet gjendja momentale në aspekt të numrit të personave të vendosur, kapacitetet strehuese në këtë institucion, si dhe të bisedohet me personat zyrtarë përgjegjës dhe me shfrytëzuesit në IP Entin special-Demir Kapi.

Në këtë drejtim, ekipi i MPN-së së bashku me bashkëpunëtorin e angazhuar të jashtëm realizoi bisedime të drejtpërdrejta me drejtoreshën e IP Entit special-Demir Kapi, me punonjës zyrtarë, si dhe me disa shfrytëzues të entit. Me ç'rast, u krye edhe inspektim në evidencën dhe dokumentet të cilat i kanë në dispozicion personat përgjegjës, pas kësaj, ekipi i MPN-së u nda në dy ekipe, duke kryer inspektim të plotë mbi kapacitetet strehuese, kushtet materiale dhe trajtimin ndaj shfrytëzuesve.

Gjatë vizitës u konstatua se në IP Entin special-Demir Kapi janë vendosur 226 shfrytëzues, ndërsa rreth 50 persona janë në listën e pritjes për vendosje në institucion ose një mesatare prej 2-3 kërkesa të reja për vendosje të shfrytëzuesve të rinj në ditë.

Sa i përket personelit të punësuar në IP Entin special-Demir Kapi, ekipi i MPN-së u informua se për momentin në këtë ent punojnë 151 person, edhe pse konform Rregullores për sistematizim të vendeve të punës në IP Entin special-Demir Kapi është parashikuar numri prej 227 personave, që flet për nevojën për personel plotësues dhe punësim të njerëzve të rinj.

Gjatë vizitës është konstatuar se kushtet e këqija materiale në Entin special-Demir Kapi, paraqesin rrezik serioz shëndetësor për shfrytëzuesit e vendosur në Ent. Nga vizita e Entit, ekipi i MPN-së konstatoi ndërtesa të dëmtuara, prezencë të lagështisë dhe kundërmimit të pakëndshëm në objektet strehuese, si dhe higjienë të nivelit të pakënaqshëm. Ajo që veçanërisht brengosë është gjendja e nyjeve sanitarike në ent, jofunksionaliteti i tualetëve dhe dushëve, me çka vihet në pyetje mirëmbajtja e rregullt e higjienës së këtyre shfrytëzuesve.

Sa i përket sigurimit të mbrojtjes shëndetësore në Ent, edhe pse pranuar informatë se është punësuar mjeku i cili është dërguar për specializim, në mungesë të tij shërbimet e mbrojtjes primare shëndetësore sigurohen nga ana e mjekut amë të angazhuar nga Demir Kapia dhe nga infermieret të cilat për çdo ditë ndajnë terapi, MPN-ja konstatoi se është e nevojshme mbrojtje më serioze e rregullt dhe e përhershme shëndetësore nga mjeku i pranishëm në ent.

Për vizitën në IP Entin special-Demir Kapi, kushtet materiale, trajtimin, veprimet ndaj shfrytëzuesve, mbrojtjen shëndetësore, realizimin e të drejtave të të përkujdesurve, si dhe për gjendje të tjera të konstatuara, ekipi i MPN-së përmes konstatimeve dhe rekomandimeve në Raportin e veçantë për këtë institucion i cili dërgohet pranë ministrive dhe institucioneve kompetente, synon të kontribuojë në përmirësimin e kushteve dhe trajtimin e shfrytëzuesve në IP Entin special-Demir Kapi.